

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. Nr. 19/23**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga, Kimete Gashi Kryetare, Agon Ramadani dhe Vedat Poterqoi, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik,(OE) "Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" sh.p.k- me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica" me numër të prokurimit: 616-22-10260-2-1-1 iniciuar nga AK–Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datën 25.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- 1. Anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit** me titull: "Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica" me numër të prokurimit: 616-22-10260-2-1-1 iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
- 2. Mbetet në fuqi**, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, për anulim të aktivitetit të prokurimit i datës 28.12.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica" me numër të prokurimit: 616-22-10260-2-1-1 iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
- 3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.** Ndërsa, obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A r s y e t i m**

### ***- Faktet dhe rrethanat procedurale –***

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 06.01.2023, ka pranuar ankesë nga OE “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Master plani për rigjenerimin e lagjes Kolovica” me numër të prokurimit: 616-22-10260-2-1-1 iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 19/2023.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar “Shërbime”, Procedurë e Hapur vlera e parashikuar e kontratës: 400,000.00 €.

Për aktivitetin e prokurimit në fjalë Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datën 28.12.2022, ka publikuar njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, për anulim të aktivitetit të prokurimit të sipër shënuar.

Me datë 29.12.2022, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, ndërsa me datë 30.12.2022 Kuvendi i Komunës së Prishtinës, e refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 20 janar 2023 me raportin e ekspertizës.

Me datë 23 janar 2023 OE “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k, ka deklaruar se nuk pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq AK Komuna e Prishtinës nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

### ***- Vlerësimi dhe administrimi i provave –***

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 20.01.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k, të refuzohet si e pa bazuar,

- të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 28.12.2023, (vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit).

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k. Prishtinë.

Pretendimi

Lidhur me pretendimin e OE “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k, Prishtinë se AK-Kuvendi i Komunës se Prishtinës ka refuzuar tenderin tonë duke cituar si vijon: “Ju menaxher të projektit e keni caktuar personin me profesion urbanist e jo inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe për këtë arsye është refuzuar tenderi juaj.”


Përgjigje në pretendim

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga operatori ekonomik “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k Prishtinë se AK-ja Kuvendi i Komunës se Prishtinës e ka refuzuar tenderin me arsyetim se: Ju menaxher të projektit e keni caktuar personin me profesion urbanist e jo inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe për këtë arsye është refuzuar tenderi juaj.”

Ekspertit shqyrtues duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmi të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, për këtë aktiviteti të prokurimit sqaron se AK-ja në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: kërkesa 2 ku është kërkuar se: OE-ik duhet të ofrojnë dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon; -Menaxheri i projektit Inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës 5 vite përvojë pune, ndërsa dëshmitë e kërkuara CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.


Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues me ofertën e tij të dorëzuar përmes platformës elektronike për kërkesën e kërkuar për Menaxher të Projektit i cili është kërkuar të jetë Inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës 5 vite përvojë, ka dorëzuar anëtarin e stafit profesional z. Flamur Kuçi-n i cili ka mbaruar kursin e plotë të Fakultetit Inxhinierisë së ndërtimit në degën arkitektura dhe merr titullin Urbanist me datën 18, shkurt 1999, me numër të Diplomës nr. 3030 të datës 06.04, 1999 me numër të regjistrimit 2512 siç po shihet nga diploma z. Flamur Kuçi ka fituar titullin Urbanist dhe jo Inxhinierë i arkitekturës si është kërkuar me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë

Shih. Diplomën me poshtë të fituar nga z. Flamur Kuçi, ku është shënuar Fakulteti , Universiteti



—dega si dhe titulli i fituar.

z. Flamur Kuçi me datën 22 shtator 2004 në universitetin



Merr titullin:

**MASTER OF ARTS  
IN URBAN MANAGEMENT**

Pra edhe kjo diplomë e masterit nuk e plotëson kërkesën e kërkuar me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

z. Flamur Kuçi me datën 30.01.2017 merr Gradën Shkencore Doktor

z. Flamur Kuçi me datën 24.07.2017, merr licencën profesionale në fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrja e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit licencën nr. A.1660/1 në projektim ku në këtë licence përshkruhet se është i Diplomuar më 1999 me titullin Urbanist.



Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Me poshtë po japim Programin mësimor të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës të Universitetit Politeknik të Tiranës të Departamentit të arkitekturës, Dega: Arkitekture, Profili : Arkitekt / Urbanist -5 vite studimi si dhe të Departamentit të Urbanistikës, Dega Arkitekture – Profili urbanist - 5 vite studimi



Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës Universiteti Politeknik i Tiranës		
Programi mesimor		
Viti	Departamenti i arkitekturës, Dega: Arkitektura, Profili: Arkitekt / Urbanist -5 vite	Departamenti i Urbanistikës, Dega: Arkitektura - Profili urbanist - 5 vite
I	<b>Viti I</b> <b>Semestri i parë (14 javë mësim)</b> 1 A Matematika 1 2 B Gjuhë e huaj 3 A Gjeometri descriptive 1 4 B Vizatimi i urdhë historik 5 C Materiale ndërtuese 6 A Grafika arkitekturore 7 B Analiza qytetë dhe territorit / Kyçendim i ambientit të ndërtuar	1 A Matematika 1 2 B Gjuhë e huaj 3 A Gjeometri descriptive 1 4 A Vizatimi i urdhë dhe materialit 5 C Materiale ndërtuese 6 A Grafika arkitekturore 7 B Vizatimi i ambientit të ndërtuar / Analiza qytetë dhe territorit
	<b>Semestri i dytë (14 javë mësim)</b> 8 A Matematika 2 9 A Histori arkitektura 1 10 A Gjeometri descriptive 2 11 B Bazat e projektimit arkitektural 12 A Egjenia ndërtuesh 13 A Grafika arkitekturore	8 A Matematika 2 9 A Histori arkitektura 1 10 A Gjeometri descriptive 2 11 B Bazat e projektimit arkitektural 12 A Egjenia ndërtuesh 13 A Grafika arkitekturore
II	<b>Viti II</b> <b>Semestri i parë (14 javë mësim)</b> 14 A Komunikim grafik - CAAD1 15 A Teori arkitektura 1 16 B Kompozicion, analiza forme e hapësirë 17 B Studio arkitektura 1 18 B Teknologji arkitektura 1 19 C Shkencë konstruktive 1	14 A Komunikim grafik - CAAD1 15 A Histori arkitektura 2 16 B Kompozicion, analiza forme e hapësirë 17 B Studio arkitektura 1 18 B Teknologji arkitektura 1 19 C Shkencë konstruktive 1
	<b>Semestri i dytë (14 javë mësim)</b> 20 A Komunikim grafik - CAAD2 21 A Histori arkitektura 3 22 B Kompozicion, analiza forme e hapësirë 23 B Studio arkitektura 2 24 B Teknologji arkitektura 2 25 B Bazat e projektimit urban dhe elemente të përzierit	19 A Komunikim grafik - CAAD2 20 A Histori arkitektura 3 21 B Kompozicion, analiza forme e hapësirë 22 B Studio arkitektura 2 23 B Teknologji arkitektura 2 24 B Bazat e projektimit urban dhe elemente të përzierit
III	<b>Viti III</b> <b>Semestri i parë (14 javë mësim)</b> 26 B Teori arkitektura dhe urbanistike 27 B Studio arkitektura 3 28 B Teknologji arkitektura 3 29 A Fizike teknike 30 C Shkencë konstruktive 2	24 B Teori arkitektura dhe urbanistike 25 B Studio arkitektura 3 26 B Teknologji arkitektura 3 27 A Fizike teknike 28 C Shkencë konstruktive 2
	<b>Semestri i dytë (14 javë mësim)</b> 31 B Rilevim arkitektonik dhe topografi 32 B Studio arkitektura 4 33 B Urbanistike 1 34 C Implanime ndërtuesh 35 C Konstruksione ndërtimi 1	29 B Rilevim arkitektonik dhe topografi 30 B Studio arkitektura 4 31 B Urbanistike 1 32 C Implanime ndërtuesh 33 C Konstruksione ndërtimi 1
IV	<b>Viti IV</b> <b>Semestri i parë (12 javë mësim)</b> 36 B Planifikim i mjedisit të ndërtuar 37 B Histori urbanistike 38 B Planifikim territorial 39 B Projektim urbanistik 2 40 C Legjislacion arkitektonik e urban 41 B Gjeografi urbane	34 B Studio arkitektura 5 35 C Konstruksione ndërtimi 3 36 D Komunikim grafik - CAAD3 37 B Projektim ambientat 38 B Restaurim i monumenteve të kultures 39 B Gjeometria mjedisit bashkëkohor në arkitekturë

V	<p><b>Kursimet e 12 javës (semestr)</b></p> <p>4.2 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.3 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.4 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.5 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.6 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.7 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.8 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.9 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.10 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p>	<p>4.1 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.2 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.3 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.4 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.5 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.6 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.7 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.8 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.9 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.10 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p>
	<p><b>Vite V</b></p> <p>4.1 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.2 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.3 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.4 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.5 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.6 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.7 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.8 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.9 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.10 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p>	<p>4.1 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.2 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.3 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.4 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.5 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.6 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.7 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.8 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.9 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.10 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p>
	<p><b>Kursimet e 12 javës (semestr)</b></p> <p>4.1 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.2 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.3 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.4 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.5 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.6 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.7 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.8 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.9 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.10 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p>	<p>4.1 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.2 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.3 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.4 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.5 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.6 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.7 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.8 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.9 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p> <p>4.10 B Arkitektura e ndërtimit dhe ndërtuesit</p>
	<b>Menaxher të Projektit: Inxhinier i arkitektures 5 vite përvojë</b>	<b>Menaxher të Projektit: Inxhinier urbanist</b>
	Inxhinieri i arkitektures i kerkuar me dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontrate dhe i cili duhet te jete pjese e stafit profesional - menaxher i projektit	Inxhinieri urbanist i propozuar nga OE ankaes "INSI" SH.P.K. Prishtinë per anktare te stafit profesional - Menaxher i Projektit dhe i cili nuk e ploteson kriterin e kerkuar sepse ne vitin e IV-te dhe te V-te studimeve programi mesimor ndryshon nga ai i kerkuar

Sqarim:

Eksperti Shqyrtues sqaron se OE ankues "INSI" SH.P.K Prishtinë së bashku me ankesë ka bashkangjitur një vërtetim të lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, lëshuar për z. Flamur Kuçi, i cili dëshmon se të njëjtit i njihet titulli Arkitekt dhe që studimet e tij janë të barasvlershme me titullin Master në Arkitekturë. Me numër të protokollit Nr. 547 të datës 23.12.2022 për z. Flamur Kuçi

Dëshmi:

Ka bashkangjitur dhe një referencë me numër: 2/6-5274 të datës 30.12.2022 nga Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, përkatësisht Qendrës Kombëtare për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik të MASHTI-të, sa i përket diplomës së studimeve themelore të z. Flamur Kuçi, ky institucion ka theksuar se titulli Arkitekt dhe Urbanist që Universiteti Politeknik i Tiranës ka ofruar më parë është ekuivalent me studimet e integruara të ciklit të dytë Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt dhe Urbanist, që nënkupton se edhe NARIC Kosova, titullin e fituar në studimet themelore të z. Flamur Kuçi e njeh si ekuivalent me ciklin e dytë Master të Shkencave në Arkitekturë.

Dëshmi: Përgjigje nga NARIC Kosova



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS  
ZV/DEKANI

Nr. 548 Prot.

Data 23.12.2022.

**VËRTETIM**

Vërtetohet se Z. Flamur Kuçi ka përfunduar programin 5-vjeçar pranë Fakultetit e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Arkitekturë, profili Urbanist.


Ka filluar studimet në vitin 1992 dhe i ka përfunduar në vitin 1998.

Nr. i Diplomës 3030 Nr. Regjistri 2512.


Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, kreu XIII, dispozita kalimtare dhe të fundit Neni 124, pika 2 diploma e integruar e nivelit të dytë e Z. Flamur Kuçi është ekuivalente me diplomë "Master i Shkencave", 300 (treqind) kredite. Programi 5-vjeçar, Titulli Arkitekt dhe Urbanist që fakulteti ka ofruar më parë është ekuivalent me studimet e integruara të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Arkitekturë", profili Arkitekt dhe Urbanist. Këto studime përfshijnë një sërë instrumentesh teorike në programin e studimit për të mundësuar tek studentët marrjen e bazave të nevojshme shkencore, aftësi metodike kërkimore dhe kualifikimin profesional në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës. Programi i studimit, në profilin urbanist, ka si objektiv kryesor formimin e profesionistëve të aftë të integrohen në tregun e punës, duke shfaqur njohuri të plota në ballafaqimin me projektet arkitektonike, ndërhyrjet urbane dhe zhvillimet territoriale. Programi mësimor është organizuar në mënyrë të tillë të gërshetojë sa më mirë njohuri specifike për një formim sa më të plotë për një profesion ndërdisiplinor, siç është figura e arkitektit / urbanistit. Formimi në Master Shkencor, për profilin urbanist, përmbyllet me një veprimtari të rëndësishme shkencore, me një punim diplome, e cila vë në provë njohuritë e grumbulluara dhe aftësitë sintetizuese, kreative dhe të komunikimit të kandidatit, në shërbim të ndërhyrjeve arkitekturore dhe urbane. Mbasjtësi i kësaj diplome, Master i Shkencave, mund të punësohet si projektues arkitekt dhe urbanist (profesion i rregulluar) në ndërmarrje / organizata publike apo private. Kjo diploma mundëson marrjen e Licencës profesionale, pa detyrim të kurseve të mëtejshme akademike, duke ndjekur specifikimet në legjislacionin përkatës, bazuar në vite dhe eksperiencë pune.

I lëshohet ky vërtetim sipas kërkesës së tij/saj.


ZV/DEKANI







Republika e Kosovës  
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
 Qeveria / Vlada - Government



Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke  
 i Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation  
 Zyrë e Sekretarit të Përgjithshëm / Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik NARIC

DATA:	30.12.2022
REFERENC-E:	2/6-5276
PËRZYATO:	Avokat Labinot Vata, përfaqësues i autorizuar i z. Hamir Kusi
NGA/OD/FROM:	Kumarije Gajica, Udhëheqëse në Qendrën Kombëtare për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik NARIC
TEMA/SUBJEKT/SUBJECT:	Përgjigje

Indervuar Avokat Vata,

Lidhur me kërkesën tuaj, ju njoftojmë për sa vijon:

Qendra Kombëtare për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik, merret me njohjen/ barasvlerën e diplomave të shkollave të Larta Profesionale dhe Gradave Universitare dhe gjithashtu bën Informimin Akademik, sipas kërkesave të grupeve të interesit.

Deri më tani, grada të ngjashme të fituara në Universitetin Politeknik të Tiranës, janë njohur ashtu siç janë fituar në Universitetin përkatës. Sipas dokumentit të lëshuar nga Universiteti, si autoritet përgjegjës për dhënien e gradës së nivelit të 7 (master), theksohet se titulli Arkitekt dhe Urbanist që Fakulteti ka ofruar më parë është ekuivalent me studimet e integruara të ciklit të dytë Master i Shkencave në Arkitekturë, Profili Arkitekt dhe Urbanist. Si e tillë, kjo gradë pranohet edhe nga NARIC Kosova.

NARIC e jep këtë sqarim në kuadër të komponentës së Informimit Akademik.

Me respekt,

Eksperti shqyrtues sqaron se këto dy dokumente të dorëzuar se bashku me ankesë janë dokumente të cilat duke u bazuar në LPP-se Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, paragrafi 2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Ndërsa paragrafi 3 Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive gjendjen e tyre ekzistuese, pra këto dy dokumente të bashkangjitura ankesës, datën e ekzistencës së tyre e kanë me vonë sa data 08.11.2022 datë e fundit e dorëzimit të tenderëve. Të njëjtin interpretim e jep dhe RREGULLORËJA Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 38 Sqarimi i Tenderëve, Pika 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Andaj Eksperti Shqyrtues sqaron se këto dy dokumente të bashkangjitura ankesës nga OE ankues vërtetojnë se diploma e z. Flamur Kuçi e fituar në Fakultetin Inxhinierisë së Ndërtimit në degën arkitektura dhe merr titullin Urbanist me datën 18 shkurt 1999, me numër të Diplomës nr. 3030 të datës 06.04,1999 me numër të regjistrimit 2512 se ky titulli Arkitekt dhe Urbanist që Universiteti Politeknik i Tiranës ka ofruar më parë është ekuivalent me studimet e integruara të ciklit të dytë Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt dhe Urbanist e fituar në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës në Prishtinë. për këtë aktivitet të prokurimit nuk duhet të merren si të qena. Sepse ekzistenca e tyre është me vonë se data fundit e dorëzimit të tenderëve 08.11.2022/ dhe nostrifikimi i saj nuk është bërë para datës së afatit të fundit të dorëzimit të tenderëve.

#### MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa: “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k Prishtinë, ankues të merret si e pa bazuar. Të behet anulimi i Vendimit Mbi Pezullimin e Aktivitetit të Prokurimit ndërsa Njoftim Për Vendimin e Autoriteti Kontraktues -B58 të mbetet në fuqi dhe AK-ja të vazhdojë me këtë aktivitet të prokurimit sipas procedurave të përcaktuara në LPP.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga operatori ekonomik “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k Prishtinë se AK-ja Kuvendi i Komunës së Prishtinës e ka refuzuar tenderin me arsyetim se: Ju menaxher të projektit e keni caktuar personin me profesion urbanist e jo inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe për këtë arsye është refuzuar tenderi juaj, paneli shqyrtues duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, raportin e ekspertit shqyrtues për këtë aktivitet të prokurimit vlerëson se AK-ja në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: kërkesa 2 ku është kërkuar se: OE-ik duhet të ofrojë dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon; Menaxheri i projektit Inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës 5 vite përvojë pune, ndërsa dëshmitë e kërkuara CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Eksperti shqyrtues në raportin e tij dorëzuar panelit shqyrtues ka sqaruar se OE ankues me ofertën e tij të dorëzuar përmes platformës elektronike për kërkesën e kërkuar për Menaxher të Projektit i cili është kërkuar të jetë Inxhinier i ndërtimtarisë ose arkitekturës 5 vite përvojë, ka dorëzuar anëtarin e stafit profesional z.Flamur Kuçi-n i cili ka mbaruar kursin e plotë të Fakultetit Inxhinierisë së ndërtimit në degën arkitektura dhe merr titullin Urbanist me datën 18,shkurt 1999, me numër të Diplomës nr. 3030 të datës 06.04,1999 me numër të regjistrimit 2512

siç po shihet nga diploma z. Flamur Kuçi ka fituar titullin Urbanist dhe jo Inxhinierë i arkitekturës si është kërkuar me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Pra edhe kjo diplomë e masterit nuk e plotëson kërkesën e kërkuar me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. z. Flamur Kuçi me datën 30.01.2017 merr Gradën Shkencore Doktor z. Flamur Kuçi me datën 24.07.2017, merr licencën profesionale në fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrja e Kolaudit të Punimeve të Ndërtimit licencën nr. A.1660/1 në projektim ku në këtë licencë përshkruhet se është i Diplomuar më 1999 me titullin Urbanist. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura për këtë aktivitet të prokurimit rezulton se ky pretendim ankimor i OE ankues për panelin shqyrtues është i bazuar.

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Ndërsa paragrafi 3 Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive gjendjen e tyre ekzistuese, pra këto dy dokumente të bashkangjitura ankesës, datën e ekzistencës se tyre e kane me vonë sa data 08.11.2022 datë e fundit e dorëzimit të tenderëve. Të njëjtin interpretim e jep dhe RREGULLORJA Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 38 Sqarimi i Tenderëve, Pika 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues po ashtu sqaron se nga dokumentet e bashkangjitura ankesës nga OE ankues vërtetojnë se diploma e z. Flamur Kuçit e fituar në Fakultetin Inxhinierisë së Ndërtimit në degën arkitektura dhe merr titullin Urbanist me datën 18 shkurt 1999, me numër të Diplomës nr. 3030 të datës 06.04.1999 me numër të regjistrimit 2512 se ky titulli Arkitekt dhe Urbanist që Universiteti Politeknik i Tiranës ka ofruar më parë është ekuivalent me studimet e integruara të ciklit të dytë Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt dhe Urbanist e fituar në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit nuk duhet të merren si të qëndrueshme, sepse ekzistenca e tyre është me vonë se data fundit e dorëzimit të tenderëve 08.11.2022 dhe barasvlerësimi i saj nuk është bërë para datës së afatit të fundit të dorëzimit të tenderëve.

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit

Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues  
Kimete Gashi



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

1x1 OE "Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" sh.p.k- me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.